# FLETORJA ZYRTARE
## E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Viti: 2020 – Numri: 125

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

**Tiranë – E hënë, 6 korrik 2020**


## PËRMBAJTJA


| | | Faqe |
|---|---|---|
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 509, datë 1.7.2020 | Për hapjen e procedurës së pranimit në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese edhe për kandidatë të tjerë jashtë shërbimit civil, për vitin 2020 | 7463 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 512, datë 1.7.2020 | Për përcaktimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e bazës të të dhënave shtetërore për informacionin kundër krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe terrorizmit | 7465 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 513, datë 1.7.2020 | Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 893, datë 4.11.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit" | 7466 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 514, datë 1.7.2020 | Për dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën 1 euro/kontrata ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si qiradhënës, dhe bashkimit të shoqërive *"Concord Investment"* sh.p.k. dhe *"Kastrati Group"* sh.a., si qiramarrës, për pasurinë shtetërore Gjiri i Limionit, Sarandë, me sipërfaqe të përgjithshme 265 2299,5 $m^2$, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural | 7467 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 515, datë 1.7.2020 | Për miratimin e kontratës së koncesionit/partneritet publik privat, për dhënien me koncesion/partneritet publik privat të portit turistik dhe të shërbimeve "Marina Limion", ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, dhe bashkimit të operatorëve ekonomikë *"Kastrati Group"* sh.a. dhe "Edil-Al-It" sh.p.k | 7472 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 521, datë 1.7.2020 | Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 692, datë 5.10.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores 'Kriteret për pajisjen me certifikatë për ushtrimin e veprimtarisë së udhërrëfyesit turistik, detyrat, përgjegjësitë dhe kodin e etikës së tyre'" | 7473 |

| | | |
|---|---|---|
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 522, datë 1.7.2020 | Për miratimin e ndryshimit të statusit, nga kategoria e resursit "tokë bujqësore" në "tokë urbane", truall, të një sipërfaqeje në pasurinë me numër 27/31 dhe të një sipërfaqeje në pasurinë me numër 27/32, zona kadastrale 1030, Bashkia Roskovec.................................. | 7473 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 523, datë 1.7.2020 | Për miratimin e çmimeve dhe të kategorive që përfitojnë falas tekstet e botuara nga Qendra e Botimeve për Diasporën, për vitin shkollor 2020–2021.................................................................................. | 7479 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 524, datë 1.7.2020 | Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rikonstruksionit të banesave individuale dhe të njësive të banimit në ndërtesa (pallat), në bashkitë Mirditë, Vorë dhe Rrogozhinë.............. | 7481 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 525, datë 1.7.2020 | Për përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për financimin e rindërtimit të Urës së Tapizës dhe caktimin e Autoritetit Rrugor Shqiptar si njësi zbatuese......................................... | 7482 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 527, datë 10.6.2020 | Për kompensimin financiar të taksës vjetore të mjeteve të përdorura, të vitit 2020, për mjetet e destinuara për transport udhëtarësh, të kategorive "M2" dhe "M3"........................................... | 7482 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 528, datë 24.6.2020 | Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, në funksion të procesit të rindërtimit në zonën 1/1 të re për Zhvillim, në Njësinë Administrative Thumanë, Bashkia Krujë.............................................................................................. | 7483 |

**VENDIM**
**Nr.509, datë 1.7.2020**

## PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË PRANIMIT NË KATEGORINË E ULËT DHE TË MESME DREJTUESE EDHE PËR KANDIDATË TË TJERË JASHTË SHËRBIMIT CIVIL, PËR VITIN 2020

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 26, të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Për vitin 2020, procedura e plotësimit të pozicioneve të lira të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese, për të cilat lëvizja paralele është mbyllur pa fitues, të jetë e hapur edhe për kandidatë të tjerë nga jashtë shërbimit civil, që plotësojnë kushtet dhe kërkesat për vendet e lira.

2. Numri maksimal i pozicioneve, për të cilat do të përdoret procedura e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, është:

a) 14 pozicione për kategorinë e mesme drejtuese;

b) 30 pozicione për kategorinë e ulët drejtuese.

3. Pozicionet në të cilat mund të konkurrojnë edhe kandidatë nga jashtë shërbimit civil për nivelin e mesëm drejtues, gjithsej 14, si dhe për nivelin e ulët drejtues, gjithsej 21, përcaktohen në lidhjen nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**Lidhja 1**

POZICIONET NË TË CILAT MUND KONKURROJNË EDHE KANDIDATË NGA JASHTË SHËRBIMIT CIVIL

I. Niveli i mesëm drejtues dhe të barazvlefshëm

1. Drejtor në Drejtorinë e të Drejtës së Autorit, në Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë për Kulturën, në Ministrinë e Kulturës- kategoria II-b;

2. Drejtor në Drejtorinë e Integrimit, Koordinimit, të Marrëveshjeve dhe Asistencës, në Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë për Kulturën, në Ministrinë e Kulturës- kategoria II-b;

3. Drejtor në Drejtorinë e Gadishmërisë dhe Koordinimit të Përgjigjes Emergjente, në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile - kategoria II-b;

4. Drejtor në Drejtorinë e Derregullimit, Lejeve, Licencave dhe Monitorimit, në Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë për Arsimin, Sportin dhe Rininë, në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë - kategoria II-b;

5. Drejtor në Drejtorinë e Programeve të Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale - kategoria II-b;

6. Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës - kategoria II-b;

7. Drejtor i Agjencisë së Mbikëqyrjes së Falimentit - kategoria II-b;

8. Drejtor në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse në Avokaturën e Shtetit - kategoria II-b;

9. Drejtor në Drejtorinë për Zbatimin e Projekteve të Bankës Botërore dhe Donatorëve të Tjerë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorëve të Tjerë - kategoria II-b;

10. Drejtor në Drejtorinë e Arkivit të Sistemit, në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Brendshme - kategoria II-b;

11. Koordinator në Drejtorinë e Politikave dhe Sistemit për Mirëqeverisje, në Njësinë e Politikave për Zhvillim dhe Mirëqeverisje, në Departamentin e Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes, në Kryeministri - kategoria II-b;

12. Drejtor i Drejtorisë së Konceptimit dhe Fizibilitetit të Projekteve të Industrisë dhe Energjisë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Industrisë dhe Energjisë, në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë - kategoria II-b.

13. Koordinator në Njësinë e Programimit të Akteve Rregullatore dhe RIA, në Departamentin

Rregullator dhe të Përputhshmërisë, në Kryeministri - kategoria II-b.

14. Koordinator në Njësinë Ligjore të Koordinimit të Nismave Prioritare dhe të Acquis, në Departamentin Rregullator dhe të Përputhshmërisë, në Kryeministri - kategoria II-b.

II. Niveli i ulët drejtues dhe të barazvlefshëm

1. Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve të Përgjithshme, në Drejtorinë e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural - kategoria III-a/1;

2. Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore, në Drejtorinë Juridike dhe Shërbimeve Mbështetëse në Agjencinë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural - kategoria III-a/1;

3. Përgjegjës i Sektorit të Promocionit dhe Komunikimit në Agjencinë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural - kategoria III-a/1;

4. Drejtor në Drejtorinë e Performancës dhe Menaxhimit të Integruar të Zonave Bregdetare, në Agjencinë Kombëtare të Bregdetit - kategoria III-a;

5. Drejtor në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Agjencinë Kombëtare të Turizmit - kategoria III-a;

6. Drejtor në Drejtorinë e Vlerësimit të Impaktit dhe Licencimit, në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit - kategoria III-a;

7. Përgjegjës i Sektorit të Financës, në Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Mbrojtjes - kategoria III-a/1;

8. Përgjegjës i Sektorit të Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit Shëndetësor, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësise dhe Mbrojtjes Sociale, në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale - kategoria III-a;

9. Përgjegjës i Sektorit të Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit Farmaceutik, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale- kategoria III-a;

10. Përgjegjës i Sektorit të Koncensioneve dhe PPP, në Drejtorinë e Koncesioneve, Prokurimeve dhe Partneriteteve, në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale- kategoria III-a;

11. Përgjegjës i Sektorit të Financës, në Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, në Drejtorinë e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Ministrinë e Drejtësisë - kategoria III - a/1;

12. Përgjegjës i Sektorit të Projekteve dhe Monitorimit të Rrjetit Antikorrupsion, në Drejtorinë e Programeve dhe Projekteve në Fushën Antikorrupsion, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave në Fushën e Drejtësisë dhe Antikorrupsionit, në Ministrinë e Drejtësisë - kategoria III-a;

13. Përgjegjës i Sektorit të Sigurimeve Shoqërore dhe Pagës Minimale, në Drejtorinë e Politikave të Punësimit dhe Aftësimit Profesional, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave të Zhvillimit Ekonomik dhe Punësimit, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë - kategoria III-a;

14. Përgjegjës i Sektorit të Koordinimit të Ofruesve dhe Zbatimit të Programeve të AFP-së, në Drejtorinë e Menaxhimit të Arsimit dhe Formimit Profesional, në Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive - kategoria III-a /1;

15. Drejtor në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore - kategoria III-a;

16. Përgjegjës i Sektorit të Administrimit të RKGJC, në Drejtorinë e Sistemeve Informatike, në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, në Ministrinë e Brendshme - kategoria III-a;

17. Sekretar i Përgjithshëm në Administratën e Prefektit të Qarkut Kukës - kategoria III-a;

18. Përgjegjës i Sektorit të Zhvillimit dhe Inovacionit të Ujit, në Drejtorinë e Menaxhimit të Performancës, në Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore - kategoria III-a/1;

19. Përgjegjës i Sektorit të Gjuhëve të Rralla, në Drejtorinë e Arkivit Qendror Shtetëror, në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave - kategoria III-a/1;

20. Përgjegjës i Sektorit të Programeve të Zhvillimit në Fushën e Gazit Natyror, në Drejtorinë e Programeve të Zhvillimit në Fushën e Hidrokarbureve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Industrisë dhe Energjisë, në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë - kategoria III-a;

21. Përgjegjës i Sektorit të Politikave Spektrale dhe Zhvillimit Broadband, në Drejtorinë e

Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Telekomunikacionit dhe Postave, në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Infrastrukturës dhe Territorit, në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë - kategoria III-a.

**VENDIM**
**Nr. 512, datë 1.7.2020**

## PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E BAZËS TË TË DHËNAVE SHTETËRORE PËR INFORMACIONIN KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR, KRIMEVE TË RËNDA DHE TERRORIZMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.10325, datë 23.9.2010, "Për bazat e të dhënave shtetërore", si dhe të pikës 5, të nenit 37, të aktit normativ nr.1, datë 31.1.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit e sigurisë publike", me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Struktura administruese e bazës të të dhënave, krijuar në bazë të nenit 37, të aktit normativ nr.1, datë 31.1.2020, të Këshillit të Ministrave, është Operacioni Forca e Ligjit (në vijim referuar OFL), në Policinë e Shtetit.

2. Regjistrimi i të dhënave në bazën e të dhënave bëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

3. Baza e të dhënave ka për qëllim administrimin, përpunimin dhe analizimin e të dhënave mbi krimin e organizuar, krimet e rënda e terrorizmin dhe përmban të dhënat e mëposhtme:

a) Çdo vendim penal, pavarësisht nëse ka marrë formë të prerë ose jo, për një nga veprat penale të parashikuara në nenin 5, të aktit normativ nr.1, datë 31.1.2020, të Këshillit të Ministrave;

b) Çdo vendim penal të dhënë jashtë shtetit ndaj shtetasve shqiptarë ose të huaj ose pa shtetësi por me banim në shtetin shqiptar, për një nga veprat penale të parashikuara në nenin 5, të aktit normativ nr.1, datë 31.1.2020, të Këshillit të Ministrave;

c) Çdo vendim mosfillimi të procedimit, të pushimit të akuzës ose të çështjes ose për dërgimin e çështjes në gjyq për një nga veprat penale të parashikuara në nenin 5, të aktit normativ nr.1, datë 31.1.2020, të Këshillit të Ministrave;

ç) Çdo vendim për marrjen e masave parandaluese personale, sipas parashikimeve të aktit normativ nr.1, datë 31.1.2020, të Këshillit të Ministrave;

d) Çdo vendim për marrjen e masave parandaluese me karakter pasuror dhe ekonomik, të marrë sipas parashikimeve të aktit normativ nr.1, datë 31.1.2020, të Këshillit të Ministrave ose sipas parashikimeve të ligjit nr.10192, datë 3.12.2009, "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", të ndryshuar.

4. Të dhënat e përcaktuara në pikën 3, të këtij vendimi, janë të dhëna parësore në bazën e të dhënave shtetërore ICMIS – Sistemi Elektronik i Regjistrimit të Çështjeve Gjyqësore, të administruar nga Ministria e Drejtësisë.

5. Të dhënat parësore të bazës të të dhënave janë elementet, si më poshtë vijon:

a) Gjykata ose autoriteti tjetër që e ka dhënë;

b) Të dhënat referenciale mbi gjenealitetet e të pandehurit, të të dënuarit ose të shtetasit ndaj të cilit është marrë vendimi, sipas shkronjave "a", "b" dhe "c", të pikës 3, të këtij vendimi, ose janë marrë masat parandaluese sipas shkronjave "ç" dhe "d", të pikës 3, të këtij vendimi, ose të dhëna të tjera personale që vlejnë për ta identifikuar si dhe gjenealitetet e palëve të tjera private;

c) Akuza ose lloji i masës parandaluese personale ose me karakter pasuror;

ç)Parashtrimi i përmbledhur i rrethanave të faktit;

d) Dispozitivi;

dh)Data dhe vendi i marrjes së vendimit.

6. Të dhënat dytësore të bazës të të dhënave janë të dhëna që merren nga:

a) Ministria e Drejtësisë;

b) Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme;

c) Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve;

ç) Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;

d) Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile;

dh) Agjencia e Prokurimit Publik;

e) Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;

ë) Qendra Kombëtare e Biznesit;

f) Instituti i Sigurimeve Shoqërore;

g) Bankat e nivelit të dytë;

gj) Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave;

h) Agjencia Shtetërore e Kadastrës;

i) Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.

7. Për të dhënat që administrohen në bazën e të dhënave ndërveprohet me:

a) bazën e të dhënave të sistemit gjyqësor;

b) bazën e të dhënave të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar;

c) bazën e të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, në kuadër të projektit të shkëmbimit të informacionit;

ç) bazën e të dhënave të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.

8. Baza e të dhënave ndërvepron me çdo sistem tjetër të Policisë së Shtetit, sipas procedurave standarde të punës të miratuara nga drejtori i Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

9. Niveli i aksesit dhe të drejtat e secilit përdorues për punonjësit e OFL-së në bazën e të dhënave përcaktohen me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, duke marrë parasysh funksionin dhe pozicionin e punës së përdoruesve.

10. Nivelet e bazës të të dhënave janë, si më poshtë vijon:

a) Përdorues;

b) Konsultues;

c) Menaxhues;

ç) Supervizor.

11. Subjektet që kanë akses të nivelit "Konsultues" në bazën e të dhënave janë, si më poshtë vijon:

a) Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar;

b) Prokuria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar;

c) Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara;

ç) Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;

d) Shërbimi Informativ i Shtetit;

dh) Komisioni i Prokurimit Publik;

e) Agjencia e Prokurimit Publik.

Aksesi në bazën e të dhënave i këtyre subjekteve është në përputhje me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e tyre dhe përcaktohet me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

12. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Operacioni Forca e Ligjit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

## VENDIM
## Nr. 513, datë 1.7.2020

## PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 893, DATË 4.11.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E INSPEKTORATIT KOMBËTAR TË MBROJTJES SË TERRITORIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 5, të nenit 8, të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007, "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme", të ndryshuar; të nenit 10, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave" dhe të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 893, datë 4.11.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Kudo në përmbajtje të vendimit, emërtesa "Ministria e Punëve të Brendshme" zëvendësohet me fjalët "… ministria përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike …" dhe fjala "… Dega …" zëvendësohet me fjalët "… Drejtoria Rajonale …".

2. Në kreun I bëhen këto ndryshime:

a) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1. Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit është institucion qendror, buxhetor, person juridik, publik, në varësi të ministrit përgjegjës për ruajtjen dhe sigurinë e territorit dhe të ndërtimeve, si dhe për parandalimin, mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe kontrollin e zbatimit të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e peizazhit, të tokës, të ajrit, të ujërave dhe të pyjeve nga ndotja,

dëmtimet apo ndërhyrje të kundërligjshme të çfarëdo lloji, me seli në Tiranë.”.

b) Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Misioni i Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit është kontrolli, mbrojtja e territorit dhe e peizazhit nga ndërhyrjet dhe zhvillimet e kundërligjshme, duke garantuar një zhvillim të qëndrueshëm e të sigurt në fushën e zhvillimit, të planifikimit, të mbrojtjes së territorit, të tokës, të ajrit, të ujërave dhe të pyjeve, të disiplinimit të punimeve në ndërtim, të produkteve të ndërtimit, si dhe në fushën e menaxhimit të integruar të burimeve ujore.”.

3. Në kreun II bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në pikën 1, pas shkronjës “ë” shtohen shkronjat “f”, “g”, “gj”, “h” dhe “i”, me këtë përmbajtje:

“f) Drejtoria Rajonale e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit Berat;

g) Drejtoria Rajonale e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit Dibër;

gj) Drejtoria Rajonale e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit Elbasan;

h) Drejtoria Rajonale e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit Fier;

i) Drejtoria Rajonale e Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit Lezhë.”.

b) Në pikën 4, fjalët “… në ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007, ‘Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme’, të ndryshuar …” zëvendësohen me “… në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e territorit, peizazhit dhe pyjeve nga ndërhyrjet e kundërligjshme …”.

c) Në pikën 5, fjalët “… rajonal përkatës …” zëvendësohen me “… përkatës në bazë qarku …”.

4. Në pikën 4, të kreut IV, fjalët “... me nenin 11, të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007, ‘Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme’” zëvendësohen me “… me dispozitat ligjore në fuqi.”.

II. Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

## VENDIM
## Nr. 514, datë 1.7.2020

## PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PËR LIDHJEN E KONTRATËS SË QIRASË ME TARIFËN 1 EURO/KONTRATA NDËRMJET MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË, SI QIRADHËNËS, DHE BASHKIMIT TË SHOQËRIVE *“CONCORD INVESTMENT”* SHPK DHE *“KASTRATI GROUP”* SHA, SI QIRAMARRËS, PËR PASURINË SHTETËRORE GJIRI I LIMIONIT, SARANDË, ME SIPËRFAQE TË PËRGJITHSHME 265 2299,5 m$^2$, NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË MBROJTJES DHE TË MINISTRISË SË BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9967, datë 24.7.2008, “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 4, datë 9.7.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore, të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve”, dhe të vendimit nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontratave të tjera të pasurisë shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën 1 euro/kontrata ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si qiradhënës, dhe bashkimit të shoqërive *“Concord Investment”* sh.p.k. dhe *“Kastrati Group”* sh.a., si qiramarrës, për pasurinë shtetërore me sipërfaqe të përgjithshme 265 2299,5 m$^2$ dhe, konkretisht, pasuritë me nr. 1/552, vol. 46 f. 205, truall me sipërfaqe 208.693,5 m$^2$; pasuria me nr. 1/416, vol. 30, f. 157, truall me sipërfaqe 39.446 m$^2$; pasuria me nr. 1 /547, vol. 40, f. 200, truall me sipërfaqe 1626 m$^2$; pasuria me nr. 1/548, vol. 46, f. 201, truall me sipërfaqe 11130 m$^2$, zona kadastrale 8642, në

pronësi dhe përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe pasuria nr. 1/420 vol. 41, f. 178, truall me sipërfaqe 2502 $m^2$, në zonën kadastrale 6842 dhe pasuria nr. 4/160, vol. 60, f. 44, truall me sipërfaqe 1902 $m^2$, zona kadastrale 8641, në pronësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për një periudhë 20 (njëzet) vjet, sipas genplanit dhe tekstit të projektkontratës që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**ZYRA E NOTERISË TIRANË**
**Nr. ______ rep.**
**Nr. ______ kol.**

**KONTRATË QIRAJE**
**Me çmimin simbolik 1 euro/kontrata**

**Lidhur**

Në Tiranë, sot, më datën ________, të muajit _________, të vitit 2020 (dy mijë e njëzet), u paraqitën para meje noterit___________________, palët kontraktuese si më poshtë vijon:

**Ministria e Financave dhe Ekonomisë**, përfaqësuar me autorizim të ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.____prot., datë___.___.2020, nga_________________, i datëlindjes______, banues në Tiranë, me shtetësi shqiptare, i pajisur me kartën e identitetit me nr. personal _____________, që më poshtë do të quhet **"Qiradhënësi"**,

**dhe**

Bashkimi i shoqërive *"Concord Investment"* sh.p.k. dhe *"Kastrati Group"* sh.a., me seli qendrore në Tiranë, regjistruar si person juridik dhe pajisur nga QKB-ja me NIPT, përkatësisht shoqëria *"Kastrati Group"* sh.a., me NUIS K21711502 V dhe shoqëria *"Concord Investment"* sh.p.k., me NIPT K81602049K, përfaqësuar sipas prokurës së posaçme nr. rep 816 dhe kol. 355, datë 16.6.2020 nga z. Genard Kastrati, identifikuar me letërnjoftimin personal me nr. H 80612130 F, që më poshtë do të quhet **"Qiramarrësi"**.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, me propozimin nr. 2649/8 prot., datë 18.6.2020, të Ministrisë së Mbrojtjes dhe nr. 10883/6 prot., datë 11.6.2020, të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, mbështetur në vendimin nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurive shtetërore", të ndryshuar, sipas kërkesës së bashkimit të shoqërive *"Kastrati Group"* sh.a. dhe *"Concord Investmet"* sh.p.k., me objekt: "Për marrjen me qira me tarifën simbolike 1 euro/kontrata me "ofertë të pakërkuar", të pronës shtetërore në Gjirin e Limionit Sarandë, me një sipërfaqe të përgjithshme prej 265.2299,5 $m^2$, në përgjegjësi administrimit të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, bazuar në nenet 801–825 të Kodit Civil, së bashku me Qiramarrësin, palët bien dakord të hartojnë këtë kontratë, me kushtet si më poshtë.

Neni 1
**Objekti i kontratës**

Objekti i kësaj kontrate është dhënia me qira e pasurisë shtetërore me emërtimin "Gjiri i Limionit", Sarandë, me sipërfaqe të përgjithshme 265.2299,5 $m^2$ dhe, konkretisht, pasuritë me nr. 1/552, vol. 46, f. 205, truall me sipërfaqe 208.693,5 $m^2$; pasuria me nr. 1/416, vol. 30, f. 157, truall me sipërfaqe 39.446 $m^2$; pasuria me nr. 1/547, vol. 40, f. 200, truall me sipërfaqe 1626 $m^2$; pasuria me nr. 1/548, vol. 46, f. 201, truall me sipërfaqe 11130 $m^2$, ZK 8642, në pronësi dhe përgjegjësi administrimit të Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe pasuria nr. 1/420, vol. 41, f. 178, truall me sipërfaqe 2502 $m^2$, në ZK 6842 dhe pasuria nr. 4/160, vol. 60, f. 44, truall me sipërfaqe 1902 $m^2$, ZK 8641, në pronësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për një periudhë 20 (njëzet) vjet, sipas genplanit dhe kontratës bashkëlidhur këtij vendimi.

Neni 2
**Qëllimi i përdorimit**

Qëllimi i kësaj kontrate është dhënia në gëzim të përkohshëm i objektit të përcaktuar në nenin 1, me qëllim ushtrimin e veprimtarisë në fushën e

turizmit. Investimi do të konsistojë në ndërtimin dhe operimin e infrastrukturës "Pro turizmi", duke investuar rreth **6,2 miliardë lekë** pa TVSH dhe duke punësuar minimalisht 35 punonjës.

Neni 3

**Kohëzgjatja**

Kjo kontratë është e vlefshme për një periudhë 20 (njëzet) vjet dhe hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët.

Neni 4

**Të drejtat dhe detyrimet e qiradhënësit**

4.1 Qiradhënësi, nëpërmjet Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Bujqësisë si njësi që kanë në administrim pasurinë shtetërore, dorëzon brenda një muaji nga hyrja në fuqi e kësaj kontrate, pronën e përcaktuar në nenin 1 të saj, të lirë për t'u shfrytëzuar për qëllimin e kësaj kontrate. Në momentin e dorëzimit do të hartohet procesverbali i dorëzimit të objektit që jepet me qira, i shoqëruar me foto, i cili është pjesë përbërëse e kontratës.

4.2 Qiradhënësi ka të drejtë të kontrollojë në çdo kohë për respektimin e kushteve të kësaj kontrate nga ana e Qiramarrësit.

4.3 Qiradhënësi ka të drejtë që, në çdo kohë gjatë kohëzgjatjes së kontratës, nëpërmjet njësive monitoruese të kontratës së qirasë, të monitorojë kontratën për verifikimin e zbatimit të kushteve të përcaktuara në të.

4.4 Qiradhënësi është i detyruar të garantojë Qiramarrësin për gëzimin e qetë të sendit, objekt të kësaj kontrate ndaj të tretëve, të cilët mund të ngrenë pretendime për të drejtën e tyre mbi këtë pronë. MFE-ja, në cilësinë e Qiradhënësit, nuk mban asnjë përgjegjësi ligjore për problematikat që mund t'i lindin qiramarrësit gjatë ezaurimit të kontratës me pronat private kufitare me pasuritë objekt kontrate. Çdo lloj pretendimi nga të tretët do të zgjidhet nga vetë qiramarrësi, duke përjashtuar MFE-në si Qiradhënës, nga çdo lloj detyrimi apo pasoje të mundshme.

4.5 Qiradhënësi ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës, kur Qiramarrësi shkel detyrimet e marra përsipër, duke njoftuar këtë të fundit 30 ditë përpara me shkrim.

4.6 Qiradhënësi nuk është i detyruar të garantojë Qiramarrësin nga shqetësimet e të tretëve, që pretendojnë të kenë të drejta mbi pronën.

Neni 5

**Të drejtat dhe detyrimet e qiramarrësit**

5.1 Qiramarrësi ka të drejtë që, sipas legjislacionit në fuqi, të përdorë e të gëzojë pronën e marrë me qira dhe përmirësimet e bëra në të, për gjithë kohën që është në fuqi kjo kontratë.

5.2 Qiramarrësi ka për detyrë që të përdorë sendin, objekt të kësaj kontrate, për qëllimin e parashikuar në nenin 2, në përputhje me detyrimet ligjore që rrjedhin nga legjislacioni shqiptar.

5.3 Qiramarrësi detyrohet që në pasurinë e marrë me qira, të realizojë aktivitetin sipas nenit 2 të kësaj kontrate, duke investuar sipas fazave dhe vlerave të shprehura në planin biznesin e paraqitur në komisionin e vlerësimit të dokumenteve.

5.4 Qiramarrësi detyrohet të shfrytëzojë dhe të mirëmbajë objektin e kontratës së qirasë.

5.5 Qiramarrësi detyrohet të përballojë me shpenzimet e tij, detyrimet që lidhen me dëmet e shkaktuara eventualisht palëve të treta.

5.6 Qiramarrësi detyrohet të sigurojë objektin e kontratës së qirasë, nëpërmjet policës së sigurimit.

5.7 Qiramarrësi, në funksion të zhvillimit të aktivitetit, në territorin objekt i kësaj kontrate, do të investojë për të ngritur aty kompleks me infrastrukturë "Pro turizmi", me qëllim dhe në funksion të ushtrimit të veprimtarisë në fushën e turizmit, ambiente të dedikuara argëtimit, ambiente të dedikuara mirëqenies, ambiente për biznes, ambiente akomoduese dhe shërbime hoteliere, restorante dhe bare, klube të hapura në natyrë *(Clubs)*, dyqane suveniresh dhe librari, guida turistike, porti i jahteve.

5.8 Qiramarrësi, në funksion të zhvillimit të aktivitetit dhe sipas kushteve të propozuara nga Ministria e Mbrojtjes dhe të marra përsipër nga Qiramarrësi, duhet të ruhet gatishmëria dhe operacionaliteti nëpërmjet ndërtimit të një bankine të re dhe infrastrukturë mbështetëse të saj, sipas standardeve të kërkuara.

5.9 Qiramarrësi, në funksion të zhvillimit të aktivitetit dhe sipas kushteve të propozuara nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, duhet të garantojë ndërtimin e një porti të ri për peshkim, i

cili duhet të sigurojë minimalisht të njëjtat kushte si porti ekzistues.

**Totali i vlerës së investimeve në pasurinë shtetërore, sipas planbiznesit, shkon rreth 6,2 miliardë lekë pa TVSH dhe do të përfundojë brenda 48 muajve nga data e marrjes në dorëzim të objektit dhe nxjerrjeve të lejeve përkatëse për punimet.**

Sipas planbiznesit të paraqitur, ky investim do të realizohet si vijon:

- Planifikohet që në vitin e parë të përfundohen të gjitha projektet, si edhe punimet paraprake për rregullime të terrenit dhe ngritjes së kantierit;

- Në vitin e dytë parashikohet mbërritja në kuotën në shumicën e godinave, si dhe përparim më i mirë me njësitë vila hotelerie;

- Në përfundim të vitit të tretë është parashikuar përfundimi i sistemimeve për të gjitha ndërtimet;

Në vitin e katërt do të punohet me fasada, rifinitura dhe interiore, në mënyrë që kompleksi turistik të jetë operativ.

Pavarësisht parashikimeve të realizimit si më sipër, monitorimi dhe përllogaritjet e afateve të realizimeve të investimeve të parashikuara, transferohen në kohë, gjithmonë pas datës së lejeve përkatëse të nevojshme për punime, ngritjen e aktivitetit dhe vënien në jetë të tij.

5.10 Qiramarrësi, sipas parashikimit për punësimin të shprehur në planbiznesin e paraqitur, përfundimi i investimit do të përfundojë 48 muaj nga data e marrjes në dorëzim të objektit dhe të nxjerrjes së lejeve përkatëse, do të punësojë **35 punonjës** të rinj. Pavarësisht parashikimeve të realizimit si më sipër, monitorimi dhe përllogaritjet e afateve të realizimeve të punësimit të parashikuar transferohen në kohë, gjithmonë pas datës së lejeve përkatëse të nevojshme për punime, ngritjen e aktivitetit dhe vënien në jetë të tij. Qiramarrësi detyrohet të zbatojë legjislacionin në fuqi "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi".

5.11 Qiramarrësi, në funksion të qëllimit sipas nenit 2 dhe zhvillimit të aktivitetit në territorin objekt i kësaj kontrate, në realizimin e treguesve të marrë përsipër, sipas neneve 5.7, 5.8, 5.9, detyrohet që të pajiset me leje ndërtimi dhe autorizime të posaçme nga organet kompetente.

5.12 Qiramarrësi detyrohet të paraqesë te Qiradhënësi në fillim të çdo viti, relacion me shkrim lidhur me vlerat e investimeve, të paraqitura në pasqyrat financiare vjetore të subjektit, shoqëruar me relacionin përkatës të hartuar nga eksperti kontabël i miratuar, vërtetuar me çdo dokumentacion të vlefshëm, si dhe vërtetimin nga institucionet shtetërore përkatëse për numrin e të punësuarve në objektin e marrë me qira.

5.13 Qiramarrësi detyrohet që në momentin e përfundimit të kësaj kontrate të dorëzojë pronën të padëmtuar.

5.14 Qiramarrësi, në përfundim të kësaj kontrate, ka të drejtë të heqë përmirësimet e ndashme nga prona, por pa dëmtuar atë. Qiradhënësi nuk bën kompensimin financiar të investimeve në pasuri të paluajtshme të kryera nga Qiramarrësi.

5.15 Në ngarkim të Qiramarrësit janë të gjitha tatimet dhe detyrimet që rëndojnë mbi pronën e dhënë me qira.

5.16 Qiramarrësit nuk i lejohet që pronën e dhënë me qira ta japë me nën qira ose t'ia kalojë kontratën një tjetri.

5.17 Qiramarrësi, në funksion të qëllimit dhe zhvillimit të aktivitetit, sipas nenit 2 të kësaj kontrate, në territorin objekt i kësaj kontrate, në realizimin e treguesve të marrë përsipër, sipas neneve 5.7 dhe 5.8, detyrohet që të pajiset me lejet ose autorizimet përkatëse nga organet kompetente të parashikuara nga legjislacioni shqiptar.

5.18 Qiramarrësi, në asnjë rast nuk mund ta rëndojë me barrë, pronën objekt të kësaj kontrate.

Neni 6
**Pagesa e qirasë**

6.1 Qiramarrësi detyrohet t'i paguajë Qiradhënësit detyrimin e kontratës, në vlerën 1 (një) euro.

Pagesa simbolike bëhet para se të firmoset kontrata, sipas faturës të lëshuar nga Qiradhënësi.

6.2 Para nënshkrimit të kontratës, Qiramarrësi detyrohet të paguajë garancinë e kontratës, në vlerën 2% të vlerës së investimit të marrë përsipër, sipas planbiznesit, e vërtetuar kjo, sipas faturës së lëshuar nga Qiradhënësi, e cila qëndron e ngurtësuar, në llogarinë përkatëse në buxhetin e shtetit, deri në përfundim të investimit.

6.3 Në rastet kur konstatohen parregullsi dhe zbatohen penalitete ose gjoba, Qiramarrësi do të likuidojë vlerat e krijuara në llogarinë e Qiradhënësit, sipas faturës së lëshuar nga ky i fundit.

Neni 7
**Penalitetet**

7.1 Në rastin kur Qiramarrësi, sipas përcaktimeve në pikën 5.9 të kësaj kontrate, nuk realizon vlerën e investimit, do të penalizohet me gjobë, në masën 10 për qind të vlerës së investimit të parealizuar. Nëse, pas 6 muajve, investimi vazhdon të mos realizohet, Qiradhënësi zgjidh kontratën dhe sanksionon Qiramarrësin me vlerën e garancisë së ngurtësuar në momentin e lidhjes së kësaj marrëveshje kontraktore.

7.2 Në rastin kur Qiramarrësi nuk ka realizuar nivelin e punësimit të përcaktuar në pikën 5.10, të kësaj kontrate, penalizohet me gjobë, në masën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë për çdo vend pune mesatar vjetor të pahapur.

Neni 8
**Zgjidhja e kontratës**

8.1 Kontrata zgjidhet me mbarimin e afatit të përcaktuar në pikën 3 të kësaj kontrate.

8.2 Kontrata mund të zgjidhet para afatit:

a) në marrëveshje midis palëve;

b) kur prona humbet tërësisht ose dëmtohet, për shkak të një force madhore;

c) kur Qiramarrësi shkel detyrimet e marra përsipër në nenin 5 dhe 6 të kësaj kontrate;

d) kur Qiramarrësi ndryshon destinacionin për të cilin është lidhur kontrata;

e) kur prona nevojitet për interes publik;

f) kur prona kalon në procedurë privatizimi.

8.3 Kontrata pushon automatikisht së vepruari, 30 ditë pas njoftimit me shkrim të Qiradhënësit për zgjidhjen e kontratës para afatit, sipas pikës 8.2 të saj dhe nëse Qiramarrësi nuk ka reaguar me shkrim.

Neni 9
**Përgjegjësitë e palëve**

9.1 Palët përgjigjen për mosrespektimin e kushteve të kësaj kontrate.

9.2 Në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, në përfundim të investimit, pas relacionit të paraqitur nga Qiramarrësi, sipas pikave 5.10 dhe 5.11, dhe 5.12 të kësaj kontrate, palët janë të detyruar të bëjnë akte rakordimi të përbashkëta ndërmjet administratorit të pasurisë, për nivelin e investimeve dhe punësimit të realizuara, sipas vlerave të paraqitura në pasqyrat financiare të subjektit, shoqëruar me relacionin përkatës të hartuar nga eksperti kontabël i miratuar.

9.3 Palët janë të detyruara që çdo vit të bëjnë akte rakordimi të përbashkëta për realizimin e kushteve të kontratës, në nivelin e punësimit, në nivelin e investimit dhe shlyerjen e penaliteteve ose të gjobave (në rastet kur ka të tilla) të vendosura, sipas neneve të kësaj kontrate.

9.4 Me "forcë madhore" do të kuptohet një ngjarje që është jashtë kontrollit të palëve, si: tërmetet, përmbytjet, lufta. Në këto raste, palët janë të detyruara të njoftojnë njëra-tjetrën me shkrim. Koha e parashikuar për plotësimin e detyrimeve do të zgjatet për aq kohë sa do të vazhdojnë këto rrethana.

9.5 Qiramarrësi përjashtohet nga detyrimet për kohën e vazhdimit të forcës madhore dhe moskryerjes së aktivitetit për këtë shkak. Kjo periudhë do të përcaktohet me marrëveshje midis palëve.

Neni 10
**Dispozitat e fundit**

10.1 Për gjithçka që nuk është shprehur posaçërisht në këtë kontratë, palët do t'u referohen dispozitave të Kodit Civil në fuqi.

10.2 Pjesë të kësaj kontrate janë planbiznesi i miratuar, procesverbali i marrjes në dorëzim të objektit, sipas kontratës së qirasë dhe gentplani i pronës.

10.3 Mosmarrëveshjet, që mund të lindin mes palëve gjatë zbatimit të kësaj kontrate, do të zgjidhen me mirëkuptim dhe, në rast se kjo është e pamundur, palët kanë të drejtë t'i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor që ka juridiskionin territorial dhe lëndor.

10.4 Në rast të mosmarrëveshjeve të lindura mes palëve, autorizohet njësia administruese dhe monitoruese e kontratës për ndjekjen e procedurës gjyqësore.

10.5 Kjo kontratë qiraje është e vlefshme deri në çastin, që prona publike e dhënë me qira privatizohet sipas akteve ligjore në fuqi.

Neni 11

11.1 Brenda 1 (një) muaji nga nënshkrimi i saj, kontrata duhet të regjistrohet në Drejtorinë Rajonale të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.

11.2 Shpenzimet noteriale të kësaj kontrate i ngarkohen Qiramarrësit.

11.3 Kjo kontratë është formuluar në shtatë kopje origjinale. Pasi iu lexua palëve, u kuptua, u pranua prej tyre, si dhe u nënshkrua para meje me vullnetin e tyre të plotë e të lirë. Ndërsa, unë noter ________________, në bazë të nenit 801 e vijim të Kodit Civil, e vërtetoj atë si të rregullt.

**QIRADHËNËSI**
**Ministria e Financave dhe Ekonomisë**
**Përfaqësuar nga**

**QIRAMARRËSI**
**Bashkimi i Shoqërive**
***"Concord Investment"* sh.p.k. dhe *"Kastrati Grooup"* sh.a.**
**Përfaqësuar nga**
**Genard Kastrati**




**VENDIM**
**Nr. 515, datë 1.7.2020**

**PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË KONCESIONIT/PARTNERITET PUBLIK PRIVAT, PËR DHËNIEN ME KONCESION/PARTNERITET PUBLIK PRIVAT TË PORTIT TURISTIK DHE TË SHËRBIMEVE "MARINA LIMION", NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË, DHE BASHKIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË *"KASTRATI GROUP"* SHA DHE "EDIL-AL-IT" SHPK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 41, të ligjit nr. 125/2013, "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës së koncesionit /partneritet publik privat, të portit turistik dhe të shërbimeve "Marina Limion", ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, dhe bashkimit të operatorëve ekonomikë *"Kastrati Group"* sh.a. dhe "Edil-Al-It" sh.p.k.

2. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletore Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**VENDIM**
**Nr. 521, datë 1.7.2020**

## PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 692, DATË 5.10.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES 'KRITERET PËR PAJISJEN ME CERTIFIKATË PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË UDHËRRËFYESIT TURISTIK, DETYRAT, PËRGJEGJËSITË DHE KODIN E ETIKËS SË TYRE'"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 57, të ligjit nr. 93/2015, "Për turizmin", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 692, datë 5.10.2016, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 3, emërtesa: "Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes" zëvendësohet me fjalët: "... ministria përgjegjëse për turizmin ...".

2. Në rregulloren "Kriteret për pajisjen me certifikatë për ushtrimin e veprimtarisë së udhërrëfyesit turistik, detyrat, përgjegjësitë dhe kodin e etikës së tyre", bashkëlidhur vendimit, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Pas shkronjës "ç", të pikës 2, të nenit 2, shtohet shkronja "d", me këtë përmbajtje:

"d) "Aplikim elektronik", nëpërmjet portalit qeveritar *e-Albania*, ku të mundësohet aplikimi për pajisjen me certifikatë për ushtrimin e veprimtarisë së udhërrëfyesit turistik dhe dorëzimi i dokumenteve që shoqërojnë kërkesën.".

b) Në nenin 5 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

i. Paragrafi i parë, i pikës 2, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Për t'u pajisur me certifikatën e udhërrëfyesit turistik, aplikuesi duhet të plotësojë formularin e aplikimit, i cili duhet të përmbajë:".

ii. Shkronja "ç", e pikës 2, shfuqizohet.

iii. Shkronja "a", e pikës 3, shfuqizohet.

iv. Pas shkronjës "dh", të pikës 3, shtohet shkronja "e", me këtë përmbajtje:

"e) Fotografinë për dokument të aplikuesit në format elektronik.".

c) Në nenin 10 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

i. Pika 1, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1. Udhërrëfyesi, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë para përfundimit të afatit të vlefshmërisë së certifikatës së tij, aplikon nëpërmjet formularit të aplikimit, me të njëjtat të dhëna, të parashikuara në pikën 2, të nenit 5.".

ii. Shkronja "a", e pikës 2, shfuqizohet.

iii. Pas shkronjës "d", të pikës 2, shtohet shkronja "dh", me këtë përmbajtje:

"dh) Fotografinë për dokument të aplikuesit në format elektronik.".

II. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet nga data 1 janar 2021.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**VENDIM**
**Nr. 522, datë 1.7.2020**

## PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË STATUSIT, NGA KATEGORIA E RESURSIT "TOKË BUJQËSORE" NË "TOKË URBANE", TRUALL, TË NJË SIPËRFAQEJE NË PASURINË ME NUMËR 27/31 DHE TË NJË SIPËRFAQEJE NË PASURINË ME NUMËR 27/32, ZONA KADASTRALE 1030, BASHKIA ROSKOVEC

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5/2, të nenit 11/1, të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001, "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të statusit, nga kategoria e resursit "tokë bujqësore" në "tokë urbane", truall, të një sipërfaqeje prej 1 006 (një mijë e gjashtë) m$^2$, në pasurinë me numër 27/31

dhe të një sipërfaqeje prej 1 260.7 (një mijë e dyqind e gjashtëdhjetë pikë shtatë) m$^2$, në pasurinë me numër 27/32, zona kadastrale 1030, Bashkia Roskovec, sipas certifikatave të pasurive, hartave treguese dhe lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Drejtoria e Administrimit dhe e Mbrojtjes së Tokës, qarku Fier, të pasqyrojë në dokumentacionin kadastral (LN) ndryshimin e resursit, nga "tokë bujqësore" në "tokë urbane", truall, për sipërfaqen ndërtimore, sipas lidhjes nr. 1, të pasurive me numër 27/31 dhe 27/32, zona kadastrale 1030, Njësia Administrative Strum, Bashkia Roskovec.

3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Qarkut Fier dhe Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Fier për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**Lidhja nr. 1**

| Nr. rend | Qarku | Bashkia | Zona kadastrale | Numri i pasurisë | Sipërfaqja m$^2$ | Sip. që përdoret për zhvillim m$^2$ | Sip. ndërtimore m$^2$ | Emërtimi i strukturës |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Fier | Roskovec | 1030 | 27/31 | 6600 | 1006 | 1006 | Magazinë për grumbullimin e produkteve bujqësore. |
| 2 | Fier | Roskovec | 1030 | 27/32 | 7680 | 1260.7 | 1260.7 | Magazinë 1 kat, me dhoma frigoriferike, për grumbullimin e produkteve bujqësore dhe sistemim, dhe rrethimi i fermës. |

# REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME

## ÇERTIFIKATË 1798451
### PËR VËRTETIM PRONËSIE

Zyra e Regjistrimit Z.V.R.P.P. FIER Zona Kadastrale Nr. 1030

Numri i Pasurisë 27/31 Volumi 5 Faqe 222

Adresa e Pasurisë ARAPAJ

Lloji i Pasurisë ARE

Sipërfaqja Totale 6600.00 m2

Nga kjo : Sa Truall ______ Nga kjo : Sa Ndërtesa -

Në s pallat : Kuota e pjesëmarrjes - %

**KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË**

Zoti (Zotërinjtë)

| Emri | Atësia | Mbiemri | Pjesa | Adresa |
|---|---|---|---|---|
| SABEDIN | TOFIK | HATIA | 1/1 | FIER |

- është pronar i ______
- janë bashkëpronarë sipas pjeseve më lart ______
- është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi pasurinë me numër 27/31
- kufizimet e pasurisë janë : V ______, L ______, J ______, P ______

**Kjo çertifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.**

**Kjo çertifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga i (të) interesuari (t) më datë 30/12/1899 Nr. 9459**

Data e lëshimit të çertifikatës 30/5/2019

Lëshuesi i çertifikatës
REGJISTRUESI



ASHK

HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT
(fragment)

KRYEMINISTRIA
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS
FIER

DREJTOR
ERVIN BUSHI

Vula/firma

A. IDENTIFIKIMI I PASURISE

ZONA KADASTRALE 1030 NR. I PASURISE 27/31 Vol.___ Fq.___

INDEKSI I HARTES K-34-112-152-C SHKALLA 1:2500

ADRESA E PASURISE: Rrethi FIER Q/F ARAPAJ

Rr/L.________ P/G____ Sh____ K____ Ap____

B. KUFIZIMET

V. P. 27/32

L. P. 27/27,26

J. P. 27/23

P. P. 27/29

C. PRONARI/ET

SABEDIN HATIA

D. Data: 30/05/2019 Ora: 10⁰⁰

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME

ÇERTIFIKATË 1798463
PËR VËRTETIM PRONËSIE

Zyra e Regjistrimit Z.V.R.P.P. FIER Zona Kadastrale Nr 1030
Numri i Pasurisë 27/32 Volumi 5 Faqe 223
Adresa e Pasurisë ARAPAJ
Lloji i Pasurisë ARE
Sipërfaqja Totale 7680.00 m2
Nga kjo : Sa Truall Nga kjo : Sa Ndërtesa -
Nqs pallat : Kuota e pjesëmarrjes - %

KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË

Zoti ( Zotërinjtë )

| Emri | Atësia | Mbiemri | Pjesa | Adresa |
|---|---|---|---|---|
| ABEDIN | TOFIK | HATIA | 1/1 | FIER |

- është pronar i
- janë bashkëpronarë sipas pjeseve më lart
- është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi pasurinë me numër 27/32
- Kufizimet e pasurisë janë : V , L , J , P

Kjo çertifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Kjo çertifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga i (të) interesuari (t) më datë 30/12/1899 Nr9459

Data e lëshimit të çertifikatës 30/5/2019

Lëshuesi i çertifikatës
REGJISTRUESI



ASHK

HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT
(fragment)

KRYEMINISTRIA
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS
FIER

DREJTOR
ERVIN BUSHI

Vula/firma

A. IDENTIFIKIMI I PASURISE

ZONA KADASTRALE 1030 NR. I PASURISE 27/32 Vol.___ Fq.___

INDEKSI I HARTES K-34-112-152 SHKALLA 1:2500

ADRESA E PASURISE: Rrethi FIER Q/F ARAPAJ.

Rr/L.______ P/G ______ Sh.____ K____ Ap.____

B. KUFIZIMET

V. P. 27/15

L. P.

J. P. 27/31

P. P. 27/29

C. PRONARI/ET

SABEDIN HATIA

D. Data: 30/05/2019

Ora: 10⁰⁰

**VENDIM**
**Nr. 523, datë 1.7.2020**

**PËR MIRATIMIN E ÇMIMEVE DHE TË KATEGORIVE QË PËRFITOJNË FALAS TEKSTET E BOTUARA NGA QENDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN, PËR VITIN SHKOLLOR 2020–2021**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të pikës 5, të nenit 10, të ligjit nr. 16/2018, "Për diasporën"; të pikës 19, të vendimit nr. 469, datë 26.7.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën"; të ligjit nr. 9616, datë 27.9.2006, "Për librin në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 99/2018, "Për buxhetin e vitit 2019", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Me qëllim mbështetjen e mësimit të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë, Qendra e Botimeve për Diasporën boton, siguron dhe shpërndan për kategoritë që përfitojnë falas tekstet shkollore dhe ato plotësuese për vitin shkollor 2020–2021, sipas listës 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Kategoritë që përfitojnë falas tekstet shkollore dhe ato plotësuese të botuara, të siguruara nga Qendra e Botimeve për Diasporën, janë nxënësit dhe mësuesit, sipas përcaktimeve të vendimit nr. 443, datë 26.6.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për organizimin e procesit mësimor dhe përzgjedhjen e arsimtarëve në diasporë".

3. Tekstet shkollore të botuara, të siguruara nga Qendra e Botimeve për Diasporën, duhet të jenë të pajisura nga ana e shtëpisë botuese me logon dhe pullën me hologram përkatëse.

4. Çmimet e teksteve shkollore dhe ato plotësuese për mësimdhënien në Diasporën Shqiptare vendosen në kopertinën e tyre, në përputhje me listën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Efektet financiare të këtij vendimi përballohen nga buxheti i miratuar për Qendrën e Botimeve për Diasporën.

6. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ministri i Shtetit për Diasporën dhe Qendra e Botimeve për Diasporën për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**Lista 1**

LISTA E TEKSTEVE SHKOLLORE PËR DIASPORËN,
PËR VITIN SHKOLLOR 2020–2021

| Titulli i librit | Sasia | Çmimi për copë / lekë pa TVSH |
|---|---|---|
| **Abetare** | 2532 copë | 515 |
| **Fletore pune abetareje** | 2133 copë | 249 |
| **Gjuhë shqipe 2** | 1010 copë | 472 |
| **Gjuhë shqipe 3** | 570 copë | 411 |
| **Gjuhë shqipe 4** | 507 copë | 479 |
| **Gjuhë shqipe 5** | 213 copë | 553 |
| **Gjuhë shqipe 6** | 244 copë | 562 |

| | | |
|---|---|---|
| **Gjuhë shqipe 7** | 137 copë | 431 |
| **Gjuhë shqipe 8** | 125 copë | 401 |
| **Gjuhë shqipe 9** | 130 copë | 513 |
| **Gjuhë shqipe 10** | 74 copë | 521 |
| **Gjuhë shqipe 11** | 44 copë | 549 |
| **Gjuhë shqipe 12** | 35 copë | 660 |
| **Letërsia 10** | 21 copë | 542 |
| **Letërsia 11** | 19 copë | 567 |
| **Letërsia 12** | 12 copë | 678 |
| **Matematikë 1** | 20 copë | 626 |
| **Histori 4** | 45 copë | 145 |
| **Histori 5** | 20 copë | 331 |
| **Histori 6** | 20 copë | 227 |
| **Histori 7** | 20 copë | 313 |
| **Histori 8** | 11 copë | 293 |
| **Histori 9** | 92 copë | 310 |
| **Dituri natyre 1** | 50 copë | 325 |
| **Fletore pune diturie natyre 1** | 30 copë | 298 |
| **Edukim për shoqërinë 1** | 65 copë | 239 |
| **Edukim për shoqërinë 2** | 69 copë | 171 |
| **Qytetari 3** | 55 copë | 233 |
| **Qytetari 4** | 45 copë | 248 |
| **Qytetari 5** | 15 copë | 324 |
| **Qytetari 6** | 45 copë | 212 |
| **Qytetari 7** | 30 copë | 218 |
| **Qytetari 8** | 30 copë | 279 |
| **Qytetari 9** | 20 copë | 142 |
| **Dituri natyre 2** | 40 copë | 310 |
| **Fletore pune diturie natyre 2** | 30 copë | 170 |
| **Dituri natyre 3** | 40 copë | 321 |

| | | |
|---|---|---|
| **Fletore pune diturie natyre 3** | 30 copë | 269 |
| **Fletore pune diturie natyre 4** | 30 copë | 268 |
| **Fletore pune diturie natyre 5** | 30 copë | 289 |
| **Gjeografia 6** | 4 copë | 325 |
| **Gjeografia 8** | 2 copë | 291 |
| **Gjeografia 9** | 2 copë | 296 |
| **Të mësojmë gjuhën amtare dhe kulturën shqiptare 1/sete shkollore për fillestarë** | 447 copë | 346 |
| **Të mësojmë gjuhën amtare dhe kulturën shqiptare 2/sete shkollore për më të rritur** | 549 copë | 346 |
| **Të mësojmë gjuhën amtare dhe kulturën shqiptare 3/sete shkollore për më të rritur** | 191 copë | 346 |
| **Muzikë 6** | 5 copë | 175 |
| **Muzikë 7** | 5 copë | 156 |
| **Muzikë 8** | 5 copë | 220 |
| **Muzikë 9** | 5 copë | 253 |
| **Art pamor 6** | 5 copë | 186 |
| **TOTALI** | **9908 copë** | **3 985 923 lekë pa TVSH** |

* TVSH-ja për librin, sipas ligjit nr. 96/2018, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 92/2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, është 6% (gjashtë).

**VENDIM**
**Nr. 524, datë 1.7.2020**

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E RIKONSTRUKSIONIT TË BANESAVE INDIVIDUALE DHE TË NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA (PALLAT), NË BASHKITË MIRDITË, VORË DHE RROGOZHINË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", 25 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, "Për buxhetin e vitit 2020", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën prej 316 970 000 (treqind e gjashtëmbëdhjetë milionë e nëntëqind e shtatëdhjetë mijë) lekësh, për financimin e rikonstruksionit të banesave individuale dhe të njësive të banimit në ndërtesa

(pallat), për ata individë të cilët përfitojnë nga grantet e rikonstruksionit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para, në bashkitë Mirditë, Vorë dhe Rrogozhinë.

2. Efekti financiar, sipas pikës 1, të këtij vendimi, të përballohet nga pjesa e financuar nga grantet e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2020, dhe t'u kalojë bashkive Mirditë, Vorë dhe Rrogozhinë, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Bashkisë Mirditë i transferohet fondi prej 29 820 000 (njëzet e nëntë milionë e tetëqind e njëzet mijë) lekësh;

b) Bashkisë Vorë i transferohet fondi prej 176 250 000 (njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë milionë e dyqind e pesëdhjetë mijë) lekësh;

c) Bashkisë Rrogozhinë i transferohet fondi prej 110 900 000 (njëqind e dhjetë milionë e nëntëqind mijë) lekësh.

3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe bashkitë Mirditë, Vorë dhe Rrogozhinë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**VENDIM**
**Nr. 525, datë 1.7.2020**

## PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, MIRATUAR NË BUXHETIN E VITIT 2020, PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË URËS SË TAPIZËS DHE CAKTIMIN E AUTORITETIT RRUGOR SHQIPTAR SI NJËSI ZBATUESE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" dhe "iii", 16 dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, "Për buxhetin e vitit 2020", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, për financimin e rindërtimit të Urës së Tapizës, në vlerën 151 539 896 (njëqind e pesëdhjetë e një milionë e pesëqind e tridhjetë e nëntë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë, pa TVSH.

2. Caktimin e Autoritetit Rrugor Shqiptar (ARRSH) si njësi zbatuese për rindërtimin e Urës së Tapizës.

3. Fondi i përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, i miratuar në buxhetin e vitit 2020, i shtohet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, në programin "Transporti rrugor" për Autoritetin Rrugor Shqiptar.

4. Fondet e mbetura të papërdorura, pas përfundimit të procedurave të prokurimit në zbatim të këtij vendimi, kthehen në zërin "Fondi për rindërtim", të buxhetit të shtetit.

5. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Autoriteti Rrugor Shqiptar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**VENDIM**
**Nr. 527, datë 10.6.2020**

## PËR KOMPENSIMIN FINANCIAR TË TAKSËS VJETORE TË MJETEVE TË PËRDORURA, TË VITIT 2020, PËR MJETET E DESTINUARA PËR TRANSPORT UDHËTARËSH, TË KATEGORIVE "M2" DHE "M3"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 22, pika 2, shkronjat "e" e "ë", dhe 41, të ligjit nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile", me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë dhe të ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kompensimin financiar të taksës vjetore të mjeteve të përdorura (TVMP), të vitit 2020, për mjetet e destinuara për transport udhëtarësh, të kategorive “M2” dhe “M3”. Në masën e kompensimit financiar, krahas taksës vjetore të mjeteve të përdorura, përfshihen dhe gjobat e krijuara për detyrimet e vitit 2020, të lidhura me TVMP-në.

2. Nga ky vendim përfitojnë të gjitha subjektet, individë, persona fizikë ose juridikë, të cilat shfrytëzojnë mjete të transportit rrugor në pronësi, në bashkëpronësi ose me qira, si dhe që ushtrojnë aktivitetin e transportit rrugor të udhëtarëve brenda vendit dhe pjesërisht jashtë territorit tokësor të Republikës së Shqipërisë nga transportues me seli në Republikën e Shqipërisë.

3. Sipas objektit të veprimtarisë, përfitojnë nga kompensimi financiar të gjitha subjektet që:

a) ushtrojnë veprimtarinë e transportit rrugor të udhëtarëve brenda vendit nëpërmjet:

i. shërbimeve në linja të rregullta (transporti qytetas, rrethqytetas dhe ndërqytetas);

ii. shërbimeve të rregullta, të specializuara;

iii. transporteve për llogari të vet;

iv. transporteve të rastit.

b) ushtrojnë veprimtarinë e transportit të udhëtarëve jashtë vendit nëpërmjet:

i. shërbimeve të rregullta;

ii. shërbimeve të rregullta, të specializuara;

iii. shërbimeve të rastit.

4. Nuk përfitojnë nga ky vendim të gjitha subjektet që rezultojnë debitore dhe nuk kanë kryer pagesën e TMVP-së për vitet paraardhëse. Përjashtimisht, këto subjekte përfitojnë vetëm nëse paguajnë detyrimet e prapambetura brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

5. Subjekteve përfituese, sipas pikës 3, të këtij vendimi, që kanë kryer pagesën e TVMP-së për vitin 2020, kompensimi do t’u bëhet sipas radhës së datës së pagesës së ardhshme, duke i zbritur detyrimin përkatës të paguar tashmë.

6. Vlera e kompensimit për subjektet përfituese përballohet nga fondi rezervë i krijuar i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

7. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

**VENDIM**
**Nr. 528, datë 24.6.2020**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, NË FUNKSION TË PROCESIT TË RINDËRTIMIT NË ZONËN 1/1 TË RE PËR ZHVILLIM, NË NJËSINË ADMINISTRATIVE THUMANË, BASHKIA KRUJË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar; të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”; të vendimit nr. 7, datë 6.1.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për kushtet dhe procedurat për shpronësimet, për interes publik, në funksion të procesit të rindërtimit”, të vendimit nr. 8, datë 6.1.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kushteve dhe të kritereve të përfitimit të sipërfaqeve ndërtimore në objektet e reja për banim nga subjektet që posedojnë ndërtime të klasifikuara si ndërtime pa leje” dhe të vendimit nr. 44, datë 22.1.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e zonës së re për zhvillim në Njësinë Administrative Thumanë, Bashkia Krujë, dhe caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit, si njësi zbatuese”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, në funksion të procesit të rindërtimit, që do të realizohet në zonën 1/1, Njësia Administrative

Thumanë, Bashkia Krujë, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Krujë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme që shpronësohen të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e llojit tokë "arë" dhe "kultura bujqësore", në shumën 20 932 039 (njëzet milionë e nëntëqind e tridhjetë e dy mijë e tridhjetë e nëntë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e kompensimit, prej 20 932 039 (njëzet milionë e nëntëqind e tridhjetë e dy mijë e tridhjetë e nëntë) lekësh, të përballohet nga zëri "Fondi për rindërtimin", i miratuar për vitin 2020.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2020, miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Pronarët e pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur certifikatën e pronësisë origjinale ose dublikatë, kartelën e pasurisë të rifreskuar, si dhe hartën treguese të regjistrimit pranë Bashkisë Krujë, referuar aktmarrëveshjes së lidhur.

7. Shpronësimi të fillojë menjëherë nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

8. Bashkia Krujë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, t'i kërkojë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës të kryejë regjistrimin e pasurive, pronë private, të shpronësuara, sipas legjislacionit në fuqi dhe referuar aktmarrëveshjes së lidhur.

9. Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Durrës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit, të pasqyrojë në regjistrat kadastralë ndryshimin e kategorisë së resursit të pasurive të paluajtshme nga kategoria e resursit "tokë bujqësore" në kategorinë "tokë urbane" truall.

10. Gjatë periudhës së zbatimit të projektit (përfundimin e punimeve) qytetarët, nëse nuk kanë në pronësi ose në posedim objekte të tjera banimi, do të strehohen nga njësia e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet programeve të rindërtimit, të parashikuara në aktin normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore" ose në legjislacionin në fuqi për strehimin social.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë në favor të Bashkisë Krujë për pasuritë e shpronësuara.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Bashkia Krujë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**

LISTA EMËRORE E PRONARËVE, QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK,
NË FUNKSION TË PROCESIT TË RINDËRTIMIT, PËR SHPALLJEN E ZONËS 1/1 TË RE PËR ZHVILLIM, NË NJËSINË ADMINISTRATIVE THUMANË, BASHKIA KRUJË

| Nr. | STATUSI JURIDIK | | | | TË DHËNAT (mbi pasurinë, sipas ASHK - Krujë) | | | | VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM, SIPAS LLOJIT TË PASURISË | | | | Dokumenti i pronësisë | Kompensim | VLERA TOTALE (lek) | SHËNIME |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | PRIVAT | | | SHTET | Zona kadastrale | Nr. pas. | Lloji i pas. | Sip. totale (m²) | Shpronësim tokë "arë" | | | Vegjetacion | | | | |
| | Emri | Atësia | Mbiemri | | | | | | Sip. (m²) | Çmimi (lek/m²) | Vlera (lek) | Vlera (lek) | | | | |
| 1 | MEREME | TARE | ZIRA | | 3599 THUMANË | 12/3 | ARË | 2800 | **2800** | **442** | **1,237,600** | | Kartela e Pasurisë së Paluajtshme | √ | **1,237,600** | |
| 2 | NEZIR | ADEM | ZIRA | | 3599 THUMANË | 12/2 | ARË | 1400 | **1400** | **442** | **618,800** | **348,529** | Kartela e Pasurisë së Paluajtshme | √ | **967,329** | |
| 3 | XHEMAL | ADEM | ZIRA | | 3599 THUMANË | 12/8 | ARË | 2600 | **2600** | **442** | **1,149,200** | | Kartela e Pasurisë së Paluajtshme | √ | **1,149,200** | |
| 4 | VATH | NEZIR | UKA | | 3600 THUMANË | 12/7 | ARË | 2450 | **2450** | **442** | **1,082,900** | | Kartela e Pasurisë së Paluajtshme | √ | **1,082,900** | |
| 5 | | | | SHTET | 3599 THUMANË | 12/6 | ARË | 2300 | **0** | **442** | **-** | | Kartela e Pasurisë së Paluajtshme | | **-** | |
| 6 | | | | SHTET | 3599 THUMANË | 25/1 | ARË | 4100 | **0** | **442** | **-** | | Kartela e Pasurisë së Paluajtshme | | **-** | |
| 7 | NAFIE<br>ALMA<br>EGLANTINA<br>TEUTA<br>ALFRED<br>SONILA<br>KLEVIS | SALI<br>ISMAIL<br>ISMAIL<br>ISMAIL<br>ISMAIL<br>ISMAIL<br>ISMAIL | ZIRA<br>ZIRA<br>ZIRA<br>ZIRA<br>ZIRA<br>ZIRA<br>ZIRA | | 3599 THUMANË | 25/2 | ARË | 3080 | **3080** | **442** | **1,361,360** | | Kartela e Pasurisë së Paluajtshme | √ | **1,361,360** | |
| 8 | QAZIM | NEZIR | ZIRA | | 3599 THUMANË | 26/4 | ARË | 3020 | **3020** | **442** | **1,334,840** | | Kartela e Pasurisë së Paluajtshme | √ | **1,334,840** | |
| 9 | ASTRIT | ADEM | ZIRA | | 3599 THUMANË | 26/5 | ARË | 2280 | **2280** | **442** | **1,007,760** | | Kartela e Pasurisë së Paluajtshme | √ | **1,007,760** | |
| 10 | SABA | ADEM | ZIRA | | 3599 THUMANË | 26/2 | ARË | 2280 | **2280** | **442** | **1,007,760** | | Kartela e Pasurisë së Paluajtshme | √ | **1,007,760** | |
| 11 | SABA | ADEM | ZIRA | | 3599 THUMANË | 53/6 | ARË | 2300 | **2300** | **442** | **1,016,600** | | Kartela e Pasurisë së Paluajtshme | √ | **1,016,600** | Përshkrimi i veçantë: Sek. Kons., datë.28.8.2017, N. 822276 "FS" sh.p.k. |
| 12 | ASTRIT | ADEM | ZIRA | | 3599 THUMANË | 53/5 | ARË | 2300 | **2300** | **442** | **1,016,600** | | Kartela e Pasurisë së Paluajtshme | √ | **1,016,600** | |
| 13 | ZIM | NEZIR | ZIRA | | 3599 THUMANË | 53/4 | ARË | 1550 | **1550** | **442** | **685,100** | | Kartela e Pasurisë së Paluajtshme | √ | **685,100** | |
| 14 | NAFIE<br>ALMA<br>EGLANTINA<br>TEUTA<br>ALFRED<br>SONILA<br>KLEVIS | SALI<br>ISMAIL<br>ISMAIL<br>ISMAIL<br>ISMAIL<br>ISMAIL<br>ISMAIL | ZIRA<br>ZIRA<br>ZIRA<br>ZIRA<br>ZIRA<br>ZIRA<br>ZIRA | | 3599 THUMANË | 53/3 | ARË | 2040 | **2040** | **442** | **901,680** | | Kartela e Pasurisë së Paluajtshme | √ | **901,680** | |
| 15 | XHEMAL | ADEM | ZIRA | | 3599 THUMANË | 53/2 | ARË | 1650 | **1650** | **442** | **729,300** | | Kartela e Pasurisë së Paluajtshme | √ | **729,300** | |
| 16 | MEREME | TARE | ZIRA | | 3599 THUMANË | 53/1 | ARË | 5620 | **5620** | **442** | **2,484,040** | | Kartela e Pasurisë së Paluajtshme | √ | **2,484,040** | |
| 17 | BASHKIA KRUJE | | | | 2182 KODËR THUMANË | 122/3 | ARË | 6000 | **0** | **362** | **-** | **-** | Kartela e Pasurisë së Paluajtshme | √ | **-** | |
| 18 | XHAFER | MUSTAFA | NUZI | | 3599 THUMANË | 122/2 | ARË | 9000 | **9000** | **442** | **3,978,000** | | Kartela e Pasurisë së Paluajtshme | √ | **3,978,000** | |
| 19 | ARBEN | VATH | UKA | | 2182 KODËR | 122/1 | ARË | 2685 | **2685** | **362** | **971,970** | | Kartela e Pasurisë së Paluajtshme | √ | **971,970** | Akti 108, datë 31.1.1997<br>Tipi: Përdorim Aben Vath Uka |

| | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | THUMANË | | | | | | | | | | | |
| 20 | | | | SHTET | 2182 KODËR THUMANË | 123 | KULLOTË | 9100 | **0** | **362** | **-** | | Kartela e Pasurisë së Paluajtshme | | **-** | |
| 21 | | | | SHTET | 3599 THUMANË | 50/2 | VRESHT | 10800 | **0** | **442** | **-** | | Kartela e Pasurisë së Paluajtshme | | **-** | Mbi këtë pasuri ndodhet ndërtesa me nr. 50/3, vol. 8, f. 171 dhe ndërtesa nr. 50/4, vol. 8, f. 220<br>Ndërtesat mbi këtë pasuri ndodhen në pjesën e parcelës që nuk preket nga projekti (ndodhen jashtë gjurmës së projektit). |
| 22 | | | | SHTET | 3599 THUMANË | 51/15 | ARË | 32350 | **0** | **442** | **-** | | Kartela e Pasurisë së Paluajtshme | | **-** | Mbi këtë pasuri ndodhet ndërtesa me nr. 51/27, vol. 8, f. 210; ndërtesa nr. 51/28, vol. 8, f. 220 dhe ndërtesa nr. 51/29, vol. 8, f. 221.<br>Këto ndërtesa janë jashtë zonës së projektit.<br>Ndërtesat mbi këtë pasuri ndodhen në pjesën e parcelës që nuk preket nga projekti (ndodhen jashtë gjurmës së projektit). |
| 23 | SABA | ADEM | ZIRA | | 3599 THUMANË | 51/15/1 | OBJEKT SOCIAL EKONOMIK | 127 | **0** | | | | | | **-** | Ndërtesë në proces legalizimi<br>Informacioni është sipas deklaratës së subjektit e dërguar nga ASHK Krujë, genplani bashkëlidhur vendimit për përjashtim nga legalizimi dhe procesverbalit të matjeve në terren.<br>Kjo ndërtesë ndodhet mbi parcelën me nr. 51/15, me pronar Shtetin. |
| 24 | KASTRIOT | NIKOLL | LEGISI | | 3599 THUMANË | 12/3/1 | NDËRTESË | 277 | **0** | | | | | | **-** | Ndërtesë në proces legalizimi.<br>Ndërtesë 2-katëshe në ndërtim, me sipërfaqe 114 m² në secilin kat plus ballkonet e katit të dytë<br>Informacioni është sipas deklaratës së subjektit e dërguar nga ASHK Krujë, genplani bashkëlidhur vendimit për përjashtim nga legalizimi dhe procesverbalit të matjeve në terren.<br>Kjo ndërtesë ndodhet mbi parcelat me nr. 12/7 dhe 12/3, me pronar privat. |
| 25 | | | | SHTET | 3599 THUMANË | 161 | KANAL | 2900 | **0** | | | | Kartela e Pasurisë së Paluajtshme | | **-** | |
| 26 | | | | SHTET | 2182 KODËR THUMANE | 359 | KANAL | 3000 | **0** | | | | Kartela e Pasurisë së Paluajtshme | | **-** | |
| | **SHUMA TOTALE** | | | | | | | **118,009** | **47,055** | | **20,583,510** | **348,529** | | | **20,932,039** | |

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2020 - Numri: 125
Datë: 2020/07/06 14:05:27
2c5b9adb-ab07-4f7a-95da-5d5ebcd62dfc

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)*


| | |
|---|---|
| | Formati 61x86/8 |

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 196 lekë